

KLSH merr pjesë në prezantimin e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”

Në ditën ndërkombëtare të demokracisë, Instituti Demokratik Amerikan (NDI) prezantoi gjetjet e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”.

Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë së bashku me përfaqësues nga qeveria, institucionet e pavarura dhe shoqëria civile, u mbledhën për të diskutuar strategjitë dhe masat konkrete legislative dhe mbikëqyrëse që Kuvendi mund të ndërmarrë për të frenuar në mënyrë efektive korrupsionin.

Në këtë aktivitet Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga z. Qeram Cibaku, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe zonja Dëshira Huqi, Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë.

Gjatë fjalës së tij si pjesë e panelit, zoti Cibaku u fokusua në rolin e institucioneve të pavarura të auditimit të jashtëm dhe kontributin e KLSH si agjent “i Kuvendit” në parandalimin dhe zbulimin e risqeve të korrupsionit. Sipas anketimit “Besimi në Qeverisje”, KLSH rezulton në tre institucionet që konsiderohen si mekanizma të efektshëm të llogaridhënies, krahas Kuvendit dhe medias.

KLSH ka vlerësuar bashkëpunimin e Kuvendit, (si organ mbikëqyrës dhe aktor kushtetues me rol unik), i cili mund të luaj një rol më aktiv në lidhje me vlerësimin dhe zbatimin më të efektshëm të rekomandimeve të dhëna nga institucionet e ekzekutivit. Në këtë kuadër KLSH ka intensifikuar marrëdhënien e bashkëpunimit me Kuvendin, duke informuar në vazhdimësi Kuvendin mbi rezultatet e auditimeve, duke dërguar në Kuvend gjatë periudhës 2018-2022 të 583 raporteve të auditimit.

Roli i Kuvendit bëhet veçanërisht i rëndësishëm për sa i takon marrjes në shqyrtim nga Qeveria dhe Komisionet Parlamentare të propozimeve të dërguara nga KLSH për përmirësimet e kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore, si instrument i procesit ligjor dhe i ngushtimit të hapësirave korruptive nga mungesa ose mangësitë e legjislacionit. Vetëm gjatë periudhës 2020-2022 nga ana e KLSH i janë rekomanduar Kuvendit dhe Qeverisë 171 masa për përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.



Në këtë panel, ndër të tjera u theksua se marrëdhënia e KLSH me Kuvendit është një marrëdhënie bashkëpunuese, por në saj të aktivitetit që KLSH kryen, qëndrimet mund të jenë

të ndryshme, kjo dhe për shkak të dinamikave të mjedisit të përgjithshëm dhe faktit se çështjet e raportuara nga auditimet mund të jenë komplekse.

KLSH mbështet idenë e ngritjes së një Nënkomisioni Parlamentar për Auditimin e Llogarive Publike, por u kërkua përcaktimi i qartë i qëllimit dhe fushës së përgjegjësisë së tij, i cili duhet ti shërbejë përmirësimit të shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga institucionet publike të audituara.

Nga ekspertet e NDI, deputetët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile u nënvizua kontributi i KLSH në këtë proces dhe avancimin dhe sinergjizimin e përpjekjeve të të gjithë aktorëve për përmirësimin e kulturës së menaxhimit dhe mbikëqyrjes së financave publike, forcimit të nivelit të llogaridhënës së institucioneve shtetërore dhe frenimin e korrupsionit dhe shpërdorimeve të fondeve dhe burimeve publike.